

VENDIM
Nr. 576, datë 24.6.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV LLAPAJ -
PESHKOPI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Llapaj - Peshkopi, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 941 (nëntëqind e dyzet e një) m², tokë bujqësore "arë", "truall" dhe "kullotë", në një vlerë të përgjithshme shpronësimi 111 039 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e nëntë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 111 039 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.
 5. Shpenzimet procedurale të shpronësimit të përballohen nga OST sh.a., si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin e këtij procesi.
 6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit qershor 2015.
 7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Dibër dhe Kukës të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OST sh.a.
 8. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST sh.a. dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 kV LAPAJ - PESHKOPI
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: TOKË ARË, TRUALL, KULLOTË NË QENDËR

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. shpronësimi për shtyllë m²	Vlera e shpronësimit në lekë/m²	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e pronës m²			
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Komuna Qendër Tomin											
Fshati Pollozhan											
1	2	Pretendues			3023	95	arë	14814	88	121	10648
2	3	Pretendues			3023	95	arë	14814	66	121	7986
3	4	Pretendues			3023	95	arë	14814	48	121	5808
4	5	Pretendues			3023	95	arë	14814	17	121	2057
5	6	Flamur		Cela	3023	40/6	arë	5550	17	121	2057
6	8	Kurt		Salkurti	3023	56/10	arë	2640	17	121	2057
		Baudin		Salkurti		56/11	arë	2500			
Fshati Rashnapojë											
7	10	Elmaz		Bojku	3155	35/6	arë	1000	15	121	1815
Fshati Pilafe											
8	11	Ismail		Cenga	2958	125/34	arë	2375	15	121	1815
9	12	Ruzhdi		Muda	2958	117/6	arë	508	15	121	1815
Komuna Kastriot											
Fshati Barovjan											
10	16	Ramadan		Shehu	1252	63/11	arë	4500	17	121	2057
Fshati Brest i Sipërm											
11	23	Dije		Shini	1280	57/5	arë	3770	17	121	2057
12	24	Pretendues			1280	10/38	arë	875	18	121	2178
13	25	Pretendues			1280	2/4	kullotë	3900	15	105	1575
Fshati Sohodoll											
14	27	Riza		Doc	2113	69/2/1	arë	3000	40	121	4840
Komuna Fushë-Cidhen											
Fshati Renz											
15	35	Agim		Spata	3169	17/33	arë	1100	17	121	2057
16	36	Pretendues			3169	12/20	arë	10750	18	121	2178
17	38	Pretendues			3169	9/11	arë	1000	15	121	1815
Komuna Silovë											
Fshati Shumbat											
18	42	Pretendues			3442	842	arë	422	15	121	1815
Fshati Sllatinë											
19	46	Pretendues			3475	849	arë	2240	15	121	1815
20	47	Pretendues			3475	869	arë	2625	45	121	5445
21	48	Pretendues			3475	832	arë	17434	35	121	4235
22	49	Hajrulla		Hysa	3475	1129	arë	2550	15	121	1815
23	50	Beniamin		Cekici	3475	811/2	arë	1512	15	121	1815
24	54	Pretendues			3475	112	arë	1840	51	121	6171
Fshati Veleshë											
25	61	Isuf		Hoxha	3799	199	arë	514	15	121	1815
Fshati Kalle											
26	65	Pretendues			2048	344	arë	5108	15	121	1815
27	66	Beqir		Sinani	2048	335/2	arë	1631	17	121	2057
Komuna Kala Dodës											
Fshati Shullan											
28	70	Pretendues			3440	111	arë	1540	45	121	5445
29	71	Pretendues			3440	131	kullotë	18684	35	87	3045
30	72	Pretendues			3440	5	arë	17482	18	121	2178
QARKU KUKËS											
Komuna Bushtricë											
Fshati Palush											
31	81	Isuf	Azem	Poti	2868	480/7	arë	2800	18	114	2052
Fshati Bushtricë											
32	85	Pretendues			1333	807	arë	6200	26	114	2964
33	86	Pretendues			1333	771/5	arë	608	15	114	1710
34	87	Pretendues			1333	556	arë	2800	15	114	1710
35	89	Pretendues			1333	988	kullotë	24852	23	105	2415
36	90	Pretendues			1333	243/3	kullotë	12600	15	105	1575
37	91	Hysen	Osman	Gjici	1333	240/5	arë	595	15	114	1710
		Ismen	Hakik	Gjici	1333	240/8		340			
38	95	Hysni	Brahim	Billa	1333	24/8	arë	1750	23	114	2622
Sipërfaqe totale për shpronësimi në m²									941		
SHUMA TOTALE NË LEKË PËR SHPRONËSIM									111039		